

UDHA ISLAMIE

Viti XIII - Nr. 4 (146), Prill, 2015

E përmuajshme Informative - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

TI JE MYSLIMAN, POR TI NUK JE ISLAMI!

Duhen thyer
e shkrirë akujt,
duhen falur
të penduarit,
duhen ruajtur
kufijtë e Zotit
në marrëdhëniet
farefisnore e,
gjykimi
përfundimtar
le t'i lihet Krijuesit
në ditën e gjykimit!



Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut Fuqiplotë, i Cili nëpërmjet Fjalës së Tij na udhëzoi drejt frymës së drojes së Tij në jetë dhe respektimit të marrëdhënieve farefisnore, kur tha: “Dhe kinie frikë All-llahun që me emrin e Tij përbetoheni dhe ruajeni farefisnin (akraballëkun)”¹

Salavatet dhe përshëndetjet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës, zotërisë tonë, Hz. Muhamedit (a.s), i cili na mësoi se: “Kush beson në All-llahun dhe në jetën e përtejme, le të ruajë lidhjet farefisnore”² dhe se: “Nuk do të hyjë në xhennet ai që shkëput lidhjet farefisnore”³

TË DASHUR VËLLEZËR DHE MOTRA BESIMTARË,

Para disa ditësh, një i ri musliman, më kërkoi t'i shpjegoj diçka rreth marrëdhënieve farefisnore në Islam, sepse, siç edhe më shkruante, ai kishte një problem serioz me disa të afërm, që mundoheshin t'i argumentonin se nuk ka nevojë për hyrje-dalje, pa asnjë lloj arsytimi a problem paraprak. E keqja e madhe ishte, se personat e tij të afërt, justifikoheshin se ky distancim e ka origjinën në arsyetime islame.

Shqetësimi i vëllaut tonë të nderuar më shtyu të shkruaj dhe të flas rreth kësaj teme, në kufijt e hytbes së xhumasë, me qëllimin

“SILLUNI MIRË ME TA, SEPSE ATA KANË NDËR NE BESË DHE FAREFIS!”

e mirë të tërheqjes së vëmendjes së besimtarëve, se marrëdhëniet farefisnore kanë një vend të veçantë në jetën familjare e shoqërore të muslimanit.

Nuk është e vërtetë se Islami nxit a thërret drejt distancimit me të afërmit dhe farefisnin, përkundrazi. Ajetet e shumta kur'anore dhe hadithet e sakta të panumërta, janë argumenti më i mirë dhe thirrja më e pastër drejt korrigjimit të këtyre marrëdhënieve dhe forcimit të tyre, në kuadër të harmonisë familjare dhe shoqërore.

“Imam El-Ajni, në shpjegimin e tij të haditheve të Imam Bukhariut, sqaron se ruajtja e lidhjes farefisnore, nënkupton bamirësinë ndaj të afërmeve nga gjaku dhe miqësia, butësinë ndaj tyre, marrjen me të mirë, përkujdesjen ndaj gjendjes së tyre, edhe kur ata largohen a sillen keq. Ndërsa prishje e marrëdhënieve farefisnore, është prishja e krejt sa u përmend më lart.

Ndërsa Imam Neveviu thotë se vërtetësia e lidhjes farefisnore është: butësia dhe mëshira (ndaj tyre)”⁴

E, natyrshëm, perfeksionimi i ruajtjes së kësaj fryme në marrëdhënie me farefisnin, buron nga gjendja e besimit dhe niveli i tij në zemrën dhe jetën e secilit prej nesh.

TË NDERUAR TË PRANISHËM,

Në fenë tonë, “muslimani e ka për detyrë të veprojë për respektimin e farefisit të tij, forcimin e marrëdhënieve me ta, edhe nëse ata e shkëpusin lidhjen, edhe nëse i bëjnë keq. Ai duhet të veprojë, që të dalë nga gjynahi i shkëputjes së lidhjeve farefisnore dhe të fitojë shpërblimin e lidhjes dhe afrimit. Sepse forcimi i lidhjeve farefisnore

është prej mirësjelljes islame. Kulmi i kësaj mirësjellje është: të kontaktosh atë që të ka shkëputur, t'i japësh atij që të ndalon dhe të falësh atë që të ka bërë padrejtësi”⁵

Ne si muslimanë, duhet të forcojmë sa më tepër në mes vete mësimet dhe traditat e fesë tonë, jo të ndikohemi nga shembujt e perëndimit, ku kryesisht, njeriu është thjeshtë një

*DUHEN THYER
E SHKRIRË AKUJT,
DUHEN FALUR
TË PENDUARIT,
DUHEN RUAJTUR
KUFIJTË E ZOTIT NË
MARRËDHËNIET
FAREFISNORE
E, GJYKIMI
PËRFUNDIMTAR
LE T'I LIHET KRIJUESIT
NË DITËN E GJYKIMIT!*

krijesë materialiste, egoiste, që kqyr punën e vet dhe përherë e më tepër distancohet nga lidhjet farefisnore. Në Islam, farefisi është familje dhe familja ka shenjtëri tek ne!

Vetëm kur shqiptarët u larguan nga Islami dhe mësimet e tij, ndër ta nisën të dalin në pah shfaqje primitive, që duhet të na shqetësojnë e të na bëjnë përherë e më të vëmendshëm

1. Kur'ani, En-Nisa: 1.

2. Imam Bukhari në “El-Edeb”.

3. Imam Bukhari në “El-Edeb”, po aty.

4. Shejkh Ali Esh-Sherbexhi, “El-erbaunel-mukhtare fil-fedailid-diniijeti vel-insaniije”, botimi i parë, Kuvajt, 2006, f. 312.

5. Shejkh Ali Esh-Sherbexhi, vep. e cit., f.313.



ndaj humnerave, drejt së cilave po rrugëton individ dhe shoqëria shqiptare.

Kohëve të fundit, përherë e më shumë po dëgjojmë e lexojmë për krimin në familje, për krimin në farefis e miqësi, për shkaqe krejtësisht banale, për interesa të ngushta materiale, që gjithsesi kthehen te mungesa e edukimit dhe disiplinës fetare në jetën e individit.

Nga këtu, dua të pyes se kur ka qenë hera e fundit, kur i ke dhënë selam vëllait, motrës, axhës e djalit të axhës, dajës e tezes, hallës e fëmijëve të tyre? Kur ka qenë hera e fundit që i ke dhënë dorën një të afërmi a je interesuar për të, qoftë edhe me një vizitë, një telefonatë, një sms, një email, një mesazh në ibox, a të ngjashme, sidomos sot, kur mjetet dhe mundësitë e komunikimit janë të shumta dhe të larmishme? Kur ke vizituar të sëmurin e fundit prej tyre? Ndërkohë që Resulull-llahu (a.s) thotë: “Të drejtat e muslimanit ndaj muslimanit janë gjashtë. E pyetën: Cilat janë këto të drejta, o i dërguar i All-llahut? Tha: Kur ta takosh, jepi selam (përshëndete), kur të ftojë, përgjigju, kur të kërkojë këshillë, këshilloje, kur të teshtitet e ta falënderojë All-llahun, uroje, kur të sëmuret, vizitoje, e kur të vdesë, pasojë xhenazen e tij”⁶

Në shoqërinë shqiptare, ka akoma familje e fise që kanë probleme të

trashëguara nga periudha e errët e komunizmit, ku niveli i njerzillekut të disave ra aq poshtë, sa harruan Zotin, besimin, trashëgiminë familjare, genin e virtyteve më të mira qytetare, gjakun e fisin dhe nisën edhe spiunimet brenda familjes, për interesa cinike të një periudhe të çmendur.

Duhet thyer e shkrirë akujt, duhet falur të penduarit, duhet ruajtur kufijtë e Zotit në marrëdhëniet farefisnore e, gjykimi përfundimtar le t’i lihet Krijuesit në ditën e gjykimit!

VËLLEZËR DHE MOTRA,

Në disa porosi të tij, Resulull-llahu (a.s) ka tërhequr vëmendjen tonë se ruajtja e marrëdhënieve farefisnore, është shkak për fitimin e kënaqësisë së All-llahut, shtimin dhe begatimin e rizkut dhe mirësi të tjera pa fund.

Transmetohet se i Dashtuni i jonë (a.s) ka thënë: “Ai që ka dëshirë të ketë begati në rizk, begati në kohë e jetë, le të ruajë lidhjet farefisnore”⁷

E kur një person e pyeti të dërguarin e All-llahut që ta udhëzonte drejt një pune që e afron me xhennetin dhe e largon nga xhehnemi, i tha: “Adhuroje All-llahun dhe mos i bëj shirk Atij, fale namazin, jepe zekatin dhe ruaji lidhjet farefisnore”⁸

E ndoshta, një ndër thëniet më të

mrekullueshme e më kulmore të Hz. Muhammedit (a.s) në lidhje me këtë temë dhe dimensionet e mëdha të ruajtës së lidhjeve farefisnore dhe miqësore në Islam, është edhe sihariqi i tij (a.s), kur tha: “Ju do ta çlironi Egjiptin (Misirin), një tokë ku përdoret kirati (monedha e përdorur asokohe atje). Kur të hyni atje, silluni mirë me ta, sepse ata kanë ndër ne besë dhe farefis!”⁹, ose tha: “besë dhe miqësi!”

“Imam Neveviu shpjegon se farefisi i nënkuptuar këtu, është fakti se nëna e Hz. Ismailit (a.s), (prej nga rrjedh profeti ynë) Haxherja, është prej tyre, pra egjiptiane. Ndërsa miqësia e nënkuptuar është fakti se Marija (nëna e jonë, gruaja e profetit dhe nëna e djalit të tij, Ibrahimit), është prej tyre, pra egjiptiane.”¹⁰

“Silluni mirë me ta, sepse ata kanë ndër ne besë dhe farefis!”¹¹, ose tha: “besë dhe miqësi!”

All-llahut të Madhëruar i lutemi të na bëjë prej atyre që e dëgjojnë fjalën dhe veprojnë më të mirën e saj, që ruajnë hakun e Zotit në familjet dhe farefisn e tyre dhe që dëshmojnë si muslimanë ndërtues në jetën e tyre!

(Hytbe e mbajtur në xhaminë e “Dy Vajzave”)

Shkodër, më 3 prill 2015

7. Bukhari në “El-Edeb” dhe Muslimi.

8. Bukhari dhe Muslimi, nga Ebu Ejjub El-Ensari (r.a).

9. Muslimi, nga Ebu Dherri (r.a).

10. Shejkh Ali Esh-Sherbexhi, vep. e cit., f. 319.

11. Muslimi, nga Ebu Dherri (r.a).



Dr. Muhamed V. Sulejman

Ajo që të çudit më tepër në këtë kohë është shndërrimi i njerëzve parimorë, të cilët mbajnë lart slloganin islam, në njerëz interesaxhi. Njerëzit parimorë dallohen për vendosmëri, qartësi, sinqeritet dhe nuk ndryshojnë ngjyrë. Ata janë të patundur në parimet e tyre, i mbrojnë ato sido dhe sado të ndryshojnë situatat dhe rrethanat.

Ndërsa njerëzit interesaxhi, ata janë të paqëndrueshëm dhe lara-lara. Qëndrimet e tyre sillen rreth interesave dhe janë të gatshëm të sakrifikojnë parimet për llogari të interesave. Shkojnë nga të fryjë era dhe pastaj flasin për veten e tyre me urtësi, zgjuarsis, vetëdije dhe shkathtësi.

Mjerimi i turpshëm është se shumë prej këtyre pretenduesve dhe teoricienëve kapen pas gabimeve të tyre dhe e paraqesin veten sikur ata janë ikonë të ymetit dhe elita e tij.

Ata, sipas pretendimit të tyre, janë pionierët e rilindjes dhe teoricienët e saj. I bëjnë njerëzit budallenj dhe

TI JE MYSLIMAN, POR TI NUK JE ISLAMI!

Le t'i shikojmë njerëzit se, ata janë krijesa të Allahut dhe më i dashuri i tyre tek Allahu, është ai që është më i dobishëm për ta.

janë peng i harresës së qëndrimeve të shkuara dhe rrugës së tyre (të mirë). Çdo ditë hipin mbi një modë të re, nëse ajo ka sukses, thërrasin me zë të lartë se ata janë pionierë dhe teoricienë të saj dhe nëse dështojnë, fshihen dhe shndërrohen në një modë tjetër të re, teorizojnë për të me teori boshe, qesharake, që s'kanë asnjë vlerë.

A nuk e shikojnë këta njerëz, se ndoshta ata ka rënë nga respekti i Zotit, përpara se të bien nga respekti i njerëzve?

Një grup tjetër, e kanë emëruar veten e tyre vekilë të Islamit dhe myslimanëve, nëse flasin, atëherë urtësia qëndron në fjalët e tyre dhe nëse heshtin, dinjiteti qëndron në atë heshtje. Nëse afroresh kufijve të tyre, do të gjesh vigjilentë, që mbrojnë shejkhin e tyre, sikur ai të jetë lajmëtar (nebij) i dërguar, duke të thënë: Kije frikë Allahun! Sikur debati në mendim, apo kërkimi i hollësive të një ideje, ose rishikimi i një fetvaje të një njeriu, që gabon dhe ia qëllon të jetë mëkat dhe nuk lejohet t'i afrohet asaj. Njerëzit duhet të marrin bereqet prej rrobave dhe gjurmëve të tyre, të kënaqen me vështirimin ndaj tyre dhe të dëgjojnë me vëmendje çfarë thonë, pa asnjë

argument, apo kuptim. Njerëzit duhet të mos mendojnë, sepse mendimi është haram (i ndaluar), të mos pyesin, sepse pyetja është e papëlqyer dhe të mos mësojnë shariat, e as fikh, sepse këto janë prej diturisë nafie (vullnetare) dhe kohës së shkuar.

Japin dëshmi faljeje për çdokënd që pason mendimin e tyre, duartroket idetë dhe mëson në mexhliset e tyre. Ndërsa dyshimi, lëkundja, poshtërimi dhe dalja nga xheneti e hyrja në xhehenem janë për secilin, që nuk vepron kështu.

O zotërinj, kemi krijuar ushtri me njerëz që nuk mendojnë, nuk kanë vetëdije, nuk njohin, nuk gjykojnë çështjet, nuk pyesin për të vërtetën dhe që të refuzojnë të kotën.

Mjaft më me ashpërsi, me stërhollime dhe me gjykime ndaj njerëzve përmes interesave dhe dëshirave tona! Le t'i shikojmë njerëzit se, ata janë krijesa të Allahut dhe më i dashuri i tyre tek Allahu, është ai që është më i dobishëm për ta.

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

MJAFT MË ME ASHPËRSI, ME STËRHOLLIME
DHE ME GJYKIME NDAJ NJERËZVE PËRMES
INTERESAVE DHE DËSHIRAVE TONA!



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Me datën 02.04.2015, mua dhe gruas sime Pitit, na erdhi një zarf nga Myftinia Shkodër. Për një çast, mendova se sot është Dita ndërkombëtare e librit për fëmijë, por është edhe Dita e autizmit.

Hapa zarfin. Ishte një ftesë, e dizajnuar bukur e plot fantazi, bashkëkohore e vizionare, por edhe lakmitare. Në të shkruhej: “Myftinia Shkodër ka kënaqësinë t’ju ftojë të merrni pjesë në ceremoninë e dhënies së titullit: “Mirënjohja e Qytetit”, studiueses së afirmuar të mjekësisë bërthamore Dr. Egesta Lopçi, akorduar nga Këshilli i Bashkisë Shkodër.”

... dhe ajo ditë e shumëpritur e datës 04., erdhi. Erdhi dhe ora 11.00. Mes pjesëmarrësve nuk ishte e vështirë të dalloje Dr. Egestën. “E thjeshtë gjer në madhësi” – m’u kujtua njëherësh një varg brilant e me hapësirë universale i shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare.

Vështrimi i saj nazik, në heshtje, me një shpirtësi e sofër bujarie sikur rrokte e përqafoje të pranishmit e më gjerë. Patjetër që rrokte e përqafoje qytetin e vendlindjes, Shkodrën e fëmijërisë, Shkodrën e ëndrrave rinore.

Mbase ajo nuk e mendonte se dhjetra sy ndiqnin me admirim e mirënjohje...

Vështrimi saj sikur nuk ngopej... Kudo ku ndaleshin ato sy, sikur shihte një gjurmë, një kujtim, një lule Shkodre, një ëndërrim...

Mbase ajo nuk e mendonte se dhjetra sy e ndiqnin me dashuri e fjalë zemre...

Vështrim i saj... diç i kujtonte... Mbase e thonin ato që e ndiqnin papushim: “Ajo iku si një dallëndyshe,

MIRËSIA E NJË SHKENCËTAREJE...

-mbresa-

për t’i ardhur qytetit të saj: një shkencëtare.”

Vështrimi i saj... Vështrimi i të pranishmëve... Hapësira malli, hapësira lotësh... Dhe pas krahëve të saj, si një mozaik i bukur qëndronin tufa e tufa lulesh... E qyteti i saj i lindjes, i përmendur për lule, doemos me lule do ta priste... Ndaj dhe vështrimi i saj ka ngjyrën e lules, ka krahët e ëndrrës... Dhe... tani... kur qetësia ka vendosur perandorinë e saj, ashtu e thjeshtë, me hap të ngadaltë si një fëshfërimë gjelbërimi, Dr. Egesta drejtohet tek foltorja, ku dhe i dorëzohet titulli: “Mirënjohja e Qytetit”.



Fjalën e ka Ajo..., që pas 15 vjetësh kthehet në vendlindje. Kësaj here e ka thirrë Vendlindja përmes propozimit të Myftinisë.

E ka fjalën Ajo... Me një shqipe për t’u admiruar, që nuk e ka tronditur trysnia e kulturës italiane; Dr. Egesta, si një bletë e mirë dhe punëtore që përzgjedh lulet, edhe ajo përzgjedh fjalët më të bukura të shqipes për t’i thënë e për t’i shprehur... Teksa flet ajo, ngjan sikur rrjedh një ujvarë që shpalos mahnitshëm një ylber shumëngjyrësh e mahnitës. Leksiku i saj është i pasur, i qartë në artikulum. Çdo fjalë i del nga shpirti. Nuk e ke vështirë të kuptosh, se era e mallit e Vendlindjes fryn pandërprerë dhe i përkëdhel fjalët e saj, zgjedhur enkas për këtë Ditë të shënuar e të paharruar. Jo, ç’them! – Fjala e bukur shqipe dhe Vendlindja kanë ndërtuar

‘folezën’ në zemrën e saj, rrahin me të dhe nuk mund të tjetërsohen. Çdo fjalë e saj ngjan si një gur i çmueshëm dhe ka një mision jetik.

Flet Dr. Egesta... Shoh tek ndonjë pjesëmarrës edhe ndonjë pikë loti në faqe, që del si pakuptuar... Edhe ai rrjedh në heshtjen e vet, për të mos trazuar solemnitetin e këtij momenti mrekullidhënës.

(Nuk e di pse m’u kujtua shkolla, ku Egesta mësoi dhe doli me ‘Medalje të Artë’. E, shkolla në personalitetin e saj duhet të dijë se ku kanë fluturuar ‘zogjtë’ e saj lavdiplotë. E, së paku, ajo shkollë duhej doemos të bënte takim me ‘bijën’ e saj shkencëtare... Ose së paku të fliste dikush nga shkolla në ceremoninë e organizuar. Siç duket, edhe shkolla, ashtu si Shkodra ime jeton në përgjumjen e saj. E them se duhej të fliste dikush, sepse arkiva duhet të mos jetë e zbrazur dhe e pluhurosur, kur në fakt me këtë ndodhi duhet të jetë krenare.)

Dr. Egesta, ti motër e nderuar myslimane! Ti sot jeton në një dhe të huaj, evropian. Papushim pret biletën dhe udhëton me trena modern. Pret në aeroporte të huaja ardhjet e avionëve për të udhëtuar drejt një shteti, ku ti, në një konferencë shkencore, në një takim kolegësh, në një mbledhje redaksie, në një zbulim, në një triumf..., do të flasësh për arritjet tuaja shkencore në mjekësinë bërthamore... Unë e di se në valixhen tënde të udhëtimit, si përherë qëndron si një relike e çmueshme: falendërim i përgjeshëm “Mirënjohja e Qytetit”, të Shkodërloces, propozuar nga Myftinia Shkodër.

Unë e di se kjo *Mirënjohje* të rri në sy e në shpirt, në labirintet e misionit tënd e në vizionet planetare... Ashtu siç të rri në shpirtin tënd dhe në udhëdrejtimin hyjnor, jetësor e njerëzor edhe ajo e Madhërishmja: Haxhi, 2010. E more atë dritë jetëdhënëse në Mekën e largët për ta shpërndarë me mirësitë e tua, moj shkencëtarja jonë shkodrane, Dr. Egesta Lopçi.

Shkodër, 04.04.2015



Naim Driaj
Imam, xhamia Parrucë

Që nga dita e parë e ardhjes në këtë botë njeriu e ka të domosdoshme që të jetë i sigurt nga çdo gjë që do ta rrezikonte apo dëmtonte atë. Nevoja për siguri është e mbjellur në instinktin e natyrës së njeriut. Ndjenja e sigurisë është njëra nga nevojat themelore të njeriut. Siguria dhe rehatia janë ndër begatitë më të çmuara që na ka dhënë Allahu (xh.sh). Siguria është njëra nga shtyllat e lumturisë dhe të suksesit. Pikërisht për këtë arsye Profeti (a.s) ka thënë: “Kush zgjohet në mëngjes duke qenë i sigurt për familjen dhe pasurinë e tij, gëzon shëndet të plotë dhe ka të siguruar ushqimin e asaj dite ta dijë se i janë dhënë të mirat e kësaj dynjaje”. Vetë Ibrahim (a.s) i është lutur Allahut (xh.sh). që t’i japë siguri vendit të tij: “O Zoti im, bëje këtë vend qytet të sigurt...” (Bekare 126).

Siguria dhe qetësia, numërohen si mirësitë më të mëdha që të fal Zoti, gjë të cilën Ai ia vë në dukje kurejshëve të Mekës: “Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes), i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike”. (Kurejsh: 3-4) Zoti e quan xhenetin, shtëpinë dhe vatrën e sigurisë dhe të stabilitetit. “Atyre do t’u thuhet: “Hyni atje me paqe dhe siguri”! (Hixhr: 46)

Përshëndetja e muslimanëve Selami është siguri: Të japësh dhe përshëndetësh me selam, do të thotë të nënshkruash marrëveshje paqeje dhe sigurie mes teje dhe tjetrit.

Siguria ditore: Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut me xhemat është në mbrojtjen e Zotit (xh.sh). (Muslim). Gruaja e cila e fal namazin e sabahut në kohë, në shtëpi,

ISLAMI, FË E SIGURISË

ka sevape sa burri që e fal sabahun në xhami. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut dhe të ikindisë hyn në xhenet. (Buhari).

Dijetarët kanë dhënë dy kuptime lidhur me këtë hadith:

1. Këtë hadith Pejgamberi (a.s) e ka thënë në fillim të Islamit, kur muslimanët kanë pasur si detyrim faljen 2 herë në ditë, para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij. Në atë kohë nuk ishin obliguar ende 5 namazet.

2. Nuk kemi argumente se Pejgamberi (a.s) këtë e ka thënë në fillim të Islamit. Ky hadith vlen si në fillim të islamit, si më vonë në ditët tona. Pejgamberi (a.s) me këtë hadith do të tregoj vlerën dhe rëndësinë që kanë këto dy namaze, por pa i nënvlehtësuar me këto fjalë veprat dhe namazet e tjera. Si p.sh. në shumë hadithe të tjera ka thënë: “Kush respekton prindërit hyn në xhenet”, “Xheneti është tek këmbët e nënës”, këto hadithe tregojnë vlerën dhe rëndësinë e prindërve në islam. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Ju shoqërojnë disa melaïke natën dhe disa të tjerë ditën dhe mblidhen në namazin e ikindisë dhe namazin e sabahut, pastaj ngrihen ata të cilët kanë qëndruar natën dhe i pyet (edhe pse All-llahu e di më mirë se ata) dhe u thotë: “Si i latë robërit e Mi?” Melaiket do të thonë: “I lamë duke falur namaz dhe kur shkua i gjetëm duke falur namaz.” (Buhariu, Muslimi).

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Ai që e fal jacinë me xhemat e ka shpërblimin si të ishte falur gjysmën e natës, kurse ai që e fal namazin e sabahut me xhemat e ka shpërblimin si të jetë falur tërë natën.” (Muslimi).

Ubej ibn Kabi ka thënë: “Një ditë na priu Pejgamberi (a.s) në namazin e sabahut dhe pastaj tha: “A e patë filanin (në xhami)?” i thanë të pranishmit: “Jo”. Tha: “Po filanin a e patë?” i thanë: “Jo.” Pejgamberi (a.s) tha: “Me të vërtetë këto dy namaze janë namazet më të vështira për munafikët dhe sikur ta kishit ditur se

çfarë shpërblimi kanë, do të vinit në xhami edhe duke u zvarritur.” (Ebu Davudi). Dijetarët thonë se munafikët janë fshehur në sabah dhe në jaci sepse në kohën e Profetit (a.s) nuk ka pasur drita.

Sigurimi i shëndetit: Tensionet e ditës dhe stresi ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe e dobësojnë sistemin imunitar ndaj sëmundjeve.

Allahu (xh.sh) thotë: “Vërtetë, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Ra’d,28). Prandaj shtojë

*“DY AJETET
E FUNDIT
TË SURES BEKARE
DO T’I MJAFTOJNË
PËR NJË NATË
KUJTDO
QË I LEXON ATO”*

përmendjen e Allahut, që të qetësohet zemra jote, të forcohet trupi dhe të gëzosh shëndet të plotë.

Sigurimi i lutjes: Nëse kërkon që të të pranohet lutja, atëherë luto për vëllanë tënd mysliman me atë dua që do të dëshiroje që ai të lutet për ty. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Lutja e myslimanit në fshehtësi për vëllanë e tij është e pranuar. Pranë tij qëndron një melek dhe sa herë që ai lutet për vëllanë e tij, meleku thotë: Amin – O Zot pranoje (Ashtu qoftë)”.

Sigurimi i gjumit: Në mënyrë që të mos të shqetësojnë ëndrrat e këqija, kujdesu që të lexosh lutjet e gjumit. Më e rëndësishmja prej tyre është leximi i Ajetit Kursij (El-Bekare 255).

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kur të

shtrihesh për të fjetur, lexoje Ajetin Kursij, sepse pranë teje do të qëndrojë një melek i dërguar nga Allahu, që të të mbrojë nga shejtani deri në agim”.

Gjithashtu Profeti (a.s) ka thënë: “Dy ajetet e fundit të sures Bekare do t’i mjaftojnë për një natë kujtdo që i lexon ato” (Buhariu).

Sigurimi kundër shejtanit: Profeti (a.s) ka thënë: “Kush thotë kur del nga shtëpia e tij: “Me emrin e Allahut, vetëm te Allahu mbështetem, nuk ka forcë as fuqi përveç forcës dhe fuqisë së Allahut” i thuhet: Të mjafton ajo që the dhe Shejtani do të largohet prej tij”. (Ibn Maxhe).

Siguria për fitimin e xhenetit: Pejgamberi (a.s) ka thënë : Kush e lexon Ajetul Kursij pas çdo namazi farz, nuk ka për ta ndaluar atë nga hyrja në xhenet asgjë përveç vdekjes. Ky hadith ka dy kuptime:

Ky njeri është gjallë, prandaj nuk ka hyrë në xhenet.

Në botën tjetër nuk ka vdekje, pra nuk e pengon asgjë për të hyrë në xhenet. (Nesai dhe Ibn Hibbani, dhe e ka saktësuar Shejh Albani).

Sejdidul-istigfar më e përzgjedhura mënyrë e pendimit.

O Allah, ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje; Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt, e unë ndaj besëlidhjes dhe premtimit Tënd do të qëndroj besnik sa të mundem, Kërkoj mbrojtjen Tëndë nga e keqja që kam vepruar. Jam mirënjohës ndaj dhuntive Tua, i pranoj gjynahet e mia, prandaj më fal, sepse vërtet gjynahet nuk i fal askush tjetër përveç Teje!

Profeti (a.s) tha: “Kush e thotë këtë lutje gjatë ditës, me bindje të plotë në lutjen e tij dhe vdes para se të ngryset, ai do të jetë banor i Xhenetit. Gjithashtu kush e thotë këtë dua në mbrëmje dhe vdes para se të agojë, ai do të jetë banor i xhenetit. (Buhari).

Siguria ndaj fatkeqësive të pa pritura: “Kush e thotë këtë dua tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje, nuk do t’i bëjë dëm asgjë.” Me emrin e Allahut pranë emrit të të Cilit nuk bën dëm asgjë në tokë dhe as në qiell, Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë. (Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Ahmedi).

KËSHILLI I MYFTINISË SHKODËR, DISKUTIME RRETH 25 VJETORIT



Ditën e martë, më 14 prill 2015, u zhvillua mbledhja e radhës e këshillit të Myftinisë Shkodër. Në qendër të vëmendjes ishte angazhimi për përkujtimin sa më dinjitoz të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë, pas 23 viteve dhunë ndaj fesë dhe besimtarëve, nga një sistem ateist imoral, që sundoi Shqipërinë, në dëm të Islamit dhe muslimanëve.

Në pasqyrën e bërë para këshilltarëve, Myftiu spikati aktivitetet kryesore që janë planifikuar të bëhen dhe të realizohen në këtë vit jubilar, duke theksuar krijimin e një grupi këshillimor, që merret me këto projekte.

U diskutua edhe mbi xhaminë e kalasë, ku Myftiu deklaroi se keqcitimi i tij rreth kësaj teme, në një shkrim të bërë për një të përditshme, nga një gazetare e Shkodrës, para dy ditëve, është i refuzuar publikisht prej tij dhe as që afrohet me qëndrimin e prerë të Myftinisë Shkodër mbi të drejtën absolute që ajo ka ndaj xhamisë së kalasë, si vakëf i shenjtë e historik. Ai theksoi se në mënyrë kategorike, as kisha katolike, as ajo ortodokse,

nuk kanë asnjë të drejtë të kërkojnë zhvillime ritualesh në atë vend të shenjtë për ne.

Një pikë e këtij takimi ishte edhe raporti i kryeredaktorit të gazetës “Udha Islame”, z. Lavdrim Hamja, i cili shpalosi planin e tij për gjallërimin e mëtejshëm të këtij botimi periodik të Myftinisë Shkodër, që hyn në vitin e tij të 13-të botimit. Ai theksoi se janë marrë disa masa në drejtim të përmirësimit të prezantimit të gazetës, sikurse po bëhen përpjekje për rritjen e cilësisë së saj në disa drejtime, që u pasqyruan në këtë mbledhje të radhës.

U lajmërua edhe zhvillimi i aktivitetit të përvitshëm, që Komunitetit Mysliman i Shqipërisë zhvillon të shtunën, më 25 prill, ora: 11.00, në Pallatin e Kongreseve, në përkujtim të vlerave të dërgesës profetike të Hz. Muhammedit (a.s).

Njëkohësisht u miratua edhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Këshillin e Bashkësisë Islame të Ulqinit, i planifikuar prej vitesh nga Myftinia Shkodër dhe i miratuar në parim edhe nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Ulqinit.



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

Qysh se u urdhërua Profeti (a.s), të luftojë (dy vjet mbas emigrimit) e mori vetë pjesë në 27 luftëra, hz. Umeri nuk mungoi në asnjërën prej tyre.

Ishte si ministër i Profetit (a.s), propozonte e zbatonte urdhrat që kishin zbritur nga Kur'ani, si p.sh. ndalimin rreptësisht të alkoolit për çdo arsye.

Në luftën e Uhud-it, e cila përfundoi me thyerjen e Kurejshive pa hyrë në Medine, kur idhujtarët filluan të lënë fushën e betejës, Ebu Sufjani (ish idhujtar dhe komandant i ushtrisë së Kurejshive) hypi mbi një përg dhe thirri më zë të lartë: A është gjallë Muhammedi?

Profeti (a.s) u tha sahabeve që mos të përgjigjen.

- A është gjallë Ebu Bekri? -pyeti përsëri Ebu Sufjani.

Profeti (a.s) përsëri porositi që të mos përgjigjen.

Ebu Sufjani vazhdoi të pyesë: A është gjallë Umeri?

Profeti (a.s) gjithnjë kërkoi nga shokët e tij të mos përgjigjen.

Atëherë Ebu Sufjani tha: Këta të tre qenkan të vrarë.

Umeri nuk duroi më, por iu përgjigj me zë të lartë: Po gënjen, hej armiku i Zotit (xh.sh), ne jemi gjallë dhe ju keni për të pasur prej nesh një të ligë.

Ndërmjet Umerit e Ebu Sufjanit u zhvillua një dialog i gjatë. Ndërsa Ebu Sufjani theksonte se kjo luftë është si lufta e Bedrit dhe vlerësonte një idhull, Umeri duke

UMERI NË JETËN E PROFETIT (A.S) NË MEDINE

u mbështetur në porosinë e Profetit (a.s) i përgjigjet se “Zoti ynë është më i lartë e më i madhërueshëm”.

Ebu Sufjani në vazhdim të shprehjes së mendimeve të veta tha: Ne kemi idhullin Uz-za e ju nuk ka kush t’ua japë atë.

Në vazhdim Ebu Sufjani kërkoi që të afrohej Umerit e të fliste me të. Profeti (a.s) e lejoi Umerin.

Ebu Sufjani me Umerin iu afruan njëri-tjetrit. Ebu Sufjani e pyeti Umerin: A e kemi vrarë Profetin (a.s)? Umeri u përgjigj: Jo, bile ai tani dëgjon fjalën tënde.

Ebu Sufjani i pohoi Umerit se ai ishte më i saktë se idhujtari që u mburr, se kishte vrarë Muhammedin.

Një dijetar thoshte se Profeti (a.s) e urdhëroi Umerin të flasë, se ka qenë i njohur për burrëri, i fortë në besim dhe, pse e ka pasur zërin të lartë.

Umeri ka qenë gjithmonë pranë me Profetin (a.s)

*ISHTE SI MINISTËR
I PROFETIT (A.S),
PROPOZONTE E
ZBATONTE URDHRAT
QË KISHIN ZBRITUR
NGA KUR’ANI,
SI P.SH. NDALIMIN
RREPTËSISHT
TË ALKOOLIT
PËR ÇDO ARSYE.*

ME SËMUNDJEN E PROFETIT (A.S)

Sa ishte Profeti (a.s) në shtrat i sëmurë, hz. Bilali thirri ezanin, mandej shkoi tek ai për t’i kallëzuar që të dalë për t’u prirë besimtarëve. Mirëpo ai Zotëri në atë gjëndje nuk kishte mundësi për ta kryer atë detyrë, prandaj urdhëroi Abdullahin, djalin e Zem-as, të lajmëronte një njeri të përshtatshëm për të bërë detyrën e imamit në të falurit në vend të Profetit (a.s)

Ebu Bekri nuk qëllloi aty, por ndodhi hz. Umeri. Atëherë Abdull-llahi kërkoi që ai të prijë. Hz. Umeri priu me zërin e tij të lartë. Kur e mësoi Profeti (a.s) këtë gjë, pyeti se ku ishte Ebu Bekri dhe tha: Zoti (xh.sh) e muslimanët nuk pëlqejnë të prijë kush tjetër jashtë Ebu Bekrit.

Mbasi bëri një falje hz. Umeri, erdhi Ebu Bekri që priu në faljet e tjera. Umeri (r.a), kur mësoi çka kishte thënë Profeti (a.s), i tha Abdull-llahit: Çka më bëre, unë kujtova se Profeti (a.s) kishte urdhëruar të prija unë? Po ta dija atë gjë përpara, nuk do të kisha prirë.

Abdull-llahi tha se vërtet nuk më urdhëroi Profetin (a.s) për ty, por, kur nuk pashë Ebu Bekrin, erdha te ti, duke menduar se je më i afti për të prirë mbas atij.

Ndërsa Profeti (a.s) ishte i sëmurë e iu shtuan dhimbjet tha: Më bini diçka të shkruaj në një shkresë, të cilën, nëse e zbatoni, nuk do të sharroni kot. Hz. Umeri u shpreh se sëmundja e ka lodhur Profetin (a.s), mos e lodhni më, na mjafton Kur’ani. Kur ai Zotëri shikoi se disa sahabë po flisnin para tij, dikush kërkonte që ai të shkruante e dikush që ai të mos shkruante, tha: Çonju, nuk bën

që ju të ndërroni fjalë para meje.

Fjala e Z.Umerit nuk qe kundra fjalës së Profetit (a.s), por qe kundra atyre që folën para Profetit (a.s), duke menduar se nuk ishte nevoja

*MË VONË
U TUBUAN SHUMË
NJERËZ NË XHAMI
TË PROFETIT (A.S),
TË CILËT I DHANË
BESËN EBU BEKRIT SI
KALIF E SE
DO TË ZBATONIN
URDHRAT E TIJ.
QYSH NË FILLIM
HZ. UMERI, SIKUR
HZ. OSMANI E HZ.
ALIU U BË DORA E
DJATHTË E KALIFATIT.*

të mërzhitej ai Zotëri, mbasi Kur'ani përmbledhë çka ka nevojë njerëzimi.

Ai Zotëri nuk desh me atë shkrim që të caktojë zëvendësin mbas tij, se nuk e përsëriti më atë kërkesë në një kohë tjetër, kur ishin tek ai hz. Aliu e hz. Abasi (r.a), se ai nuk përmendi gjë për zëvendës, kur qëndronte me vajzën e tij, zonjën Fatime (r.a). Vetë hz. Aliu (r.a) ka thënë se Profeti (a.s) nuk na ka lënë ne si familje kërkesë të veçantë për njerëzit e tjerë.

Pra, ata që mendojnë se Profeti (a.s) ka dashur të emërojë zëvendës mbas tij me atë shkresë e nuk e shkroi asnjëherë, as urdhëroi me gojë, ata akuzojnë Profetin (a.s) se ka fshehur disa prej urdhrave të Zotit (xh.sh). Zoti na ruajt, të

akuzosh atë njeri të plotë për ndonjë mungesë. Të djelën, me 11 rebiu ev-vel Profeti (a.s) shpërndau gjithë pasurinë që kishte, 7 lira arit i ndau, 1 skllav e liroi, 1 kalë e armët i fali.

Të hënën, me 12 rebiule ev-vel pushoi ai burrë që u lodh 23 vjet për hir të Zotit (xh.sh), heshti ajo zemër që përmendte Zotin (xh.sh) përherë, pushoi ajo gojë që i mësonte njerëzit në kohën e tij e deri sa të përfundojë jeta urdhrat, kërkesat e ndalimet e Zotit (xh.sh).

U mbyllën ata sy që sa e sa herë lotonin duke kënduar Kur'anin në familje e kur dëgjonte për një të ligë a të keqe që ka pësuar ndokush.

Ndërroi jetë Profeti (a.s) në mëngjes të asaj dite në parzëm të zonjës Aishe (r.a).

UMERI NË KALIFATIN SHOKUT TË VET, EBU BEKRIT

Hz. Umeri qe njeriu i parë që i dha besën Ebu Bekrit si kalif mbas Profetit (a.s), mandej dhanë besën ata që u ndodhën në atë mbledhje.

Më vonë u tubuan shumë njerëz në xhami të Profetit (a.s), të cilët i dhanë besën Ebu Bekrit si kalif e se do të zbatonin urdhrat e tij.

Qysh në fillim hz. Umeri, sikur hz. Osmani e hz. Aliu u bë dora e djathtë e kalifatit.

Brenda dy vjetëve që qëndroi Ebu Bekri kalif, hz. Umeri nuk iu largua asnjë ditë atij.

Kur u sëmur rëndë Ebu Bekri, dhe ishte në prag të vdekjes, pyeste secilin që e vizitonte: Çka thoni për të lënë mbas meje hz. Umerin si kalif? Të gjithë e pëlqenin atë propozim, e kështu u emërua kalif më 22 Xhumada Eth-Thani - 23 gusht 634

Menjëherë emëroi hz. Aliun si gjykatës dhe Abdull-llahun, djalin e Mes-udit, për financë, po ashtu emëroi edhe Zejdin etj., të cilëve u caktoi rroga të përshtatshme.



Habib Ali El-Ahifri

Të flasësh për pafajshmërinë e Islamit ndaj krimeve të havarixhëve të kohës kundër të krishterëve dhe ahbashëve, nuk ka më vlerë!

Por, heshtja e dijetarëve dhe thirrësve, ose neglizhenca e tyre në përballje me këtë mendësi të shthurur, ky është krimi i vërtetë!

Por, vrapimi i invalidëve të klasës intelektuale, për t'i instrumentalizuar krimet e havarixhëve të kohës, në funksion të kritikës ndaj trashëgimisë islame, ky është krimi i vërtetë!

Por, bashkëpunimi i politikanëve me këto organizata kriminale, nëpërmjet lojës së ekuilibrave politikë, ky është krimi i vërtetë!

Por, nënvleftësimi i të rinjve dhe lënia e tyre si pre e injorancës, varfërisë dhe shfrytëzimit, ky është krimi i vërtetë!

Zot na fal, se tek Ti do të kthehem!

Përktheu nga arabishtja:

Muhamed B. Sytari

Shkodër, 20 prill 2015

KULLAJ DI

HIDHEN THEMELET P



HE MJEDË, ËR DY XHAMI TË REJA





Arben Halluni, teolog

Israja dhe Miraxhi është një nga netët më të mëdha në besimin tonë, një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe me vlera të mëdha shpirtërore në Islam. Allahu (xh.sh) më dëshirën e tij absolute bëri që kjo ngjarje që nisi nga Qabja e nderuar të lejë gjurmë të mëdha në Bejti Mukaddes që ndodhet në Kudsën e nderuar (Palestinë), e para kible, e treta për nga shënjtëria dhe vendbashkimi i profetëve, të cilët dëshmuar te ummeti i Muhamedijes dhe te ndjenjat e tij konceptin e unifikimit si domosdoshmëri për të gjithë ithtarët e Islamit.

Isra'i dhe Miraxhi si mrekulli nga mrekullitë e profetit Muhamed (a.s) ka qenë dhe vazhdon të jetë pikë trajtimi apo diskutimi e jo konflikti që sillet rreth dy çështjeve:

E para rreth çështjes së ndodhjes së mrekullisë dhe e dyta rreth çështjes së ngritjes së Profetit me trup e më shpirt, apo vetëm me njërin prej tyre apo vetëm me shpirt...?

Për sa i përket aspektit të mrekullive të profetit të Islamit, Muhamedit (a.s), gjithmonë u janë drejtuar mendjes së njeriut dhe pa dyshim të gjitha kanë qenë të pranueshme për mendjen, ndryshe nga mrekullitë e profetëve të tjerë para tij, ku të gjitha mrekullitë u janë drejtuar gjymtyrëve lëndore, pra kanë qenë të shikueshme. P.sh mrekullia e profetit Musa (a.s), i cili për të shfaqur të trilluar magjinë e magjistarëve hodhi shkopin në tokë që menjëherë u shndërrua në gjarpër të dukshëm dhe në të njëjtën kohë ai para të pranishmëve nxori dorën që kishte marrë ngjyrë të bardhë dhe

ISRAJA DHE MIRAXHI - NATË E MADHE

(Këtë vit, Israja dhe Miraxhi përkujtohen, më 15.5.2015)

që shndriste nga bardhësia. Pra ishte një mrekulli shqisore që e panë ata që ishin të pranishëm. Një mrekulli e tillë, o të shpie në besim të plotë, ose në zili, siç ndodhi me arrogancën e vazhdueshme të Faraonit.

Po ashtu mrekullia e profetit Isa (a.s), ka qenë rivitalizimi i të vdekurve etj, dhe mrekullitë e tij kanë qenë vetëm shqisore që i kanë shpënë njerëzit në besim ose kanë mbetur në mohim nga arroganca.

Ndërsa mrekullitë e profetit Muhamed (a.s), vula dhe kunora e mbarë profetëve, Allahu (xh.sh) nuk i ka vendosur në nivelin lëndor e material, por në një nivel më të lartë e të pakrahasuar që i drejtohet logjikës dhe ndikon drejtpërsëdrejti në mendim. Të gjitha ajetet e Kur'anit

mrekullive të profetëve para Hz. Muhamedit (a.s).

Kur'ani famëlartë është mrekullia e pashuar dhe më e madhe që vërteton profetizmin dhe të shpie në besimin te Muhamedi (a.s), si i dërguari i Allahut (xh.sh). Përveç tij të gjitha ndodhitë, të shoqëruara me mrekulli shqisore e argumente kanë qenë vetëm ndodhi që kanë pasur vlerë në jetën e Profetit të Islamit e urtësia e tyre ka qenë vetëm si pjesë e mbështetjes për thirrjen në besimin në një Zot të vetëm.

Nëse vërejmë Israin dhe Miraxhin, për sa i përket profetit Muhamed (a.s), mund të themi me plot bindje e fakte se: ka qenë mrekulli, sepse ai u ngrit nga Mekka në Kudsën sherif dhe nga Kuds në qiejt më të lartë në një pjesë të natës. Ai (a.s), pau atë që iu afrua nga Madhnia e Allahut (xh.sh), pau madhësinë e universit dhe të vërtetat e ekzistencës. Njerëzit nuk panë asgjë, por dëgjuan nga i dërguari i Allahut (xh.sh) lajmet e gajbit (fshehtësisë), ku përveç tij nuk pati fatin të shihte askush atë që pau vula e mbarë të dërguarve. Për njerëzit në atë kohë kishte dy rrugë: o të besonin nëse ishin besimtarë, ose të vazhdonin të qëndronin në gjendjen e tyre mosbesuese, nëse ishin mosbesimtarë.

Për sa i përket çështjes se a ka qenë udhëtimi (ngritja) bashkë me shpirt e trup, apo vetëm me shpirt...

Mendimi i saktë që qetëson mendjen dhe që e beson zemra është se ngritja e e Profetit në ndodhinë e Israit dhe të Miraxhit ka qenë me të dyja (me shpirt e trup). Ky mendim mbështetet në ajetin e qartë: "Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet..." dhe nuk ka thënë: "me shpirtin e robit të Vet". Robi i Vet është Muhamedi, i dërguari i Allahut që është më shpirt e më trup. Ky është argumenti i parë.

Argumenti i dytë është qëndrimi dinjitoz që mbajtën njerëzit kur

**KUR'ANI FAMËLARTË
ËSHTË MREKULLIA
E PASHUAR
DHE MË E MADHE
QË VËRTETON
PROFETËSINË
E MUHAMEDI (A.S),
SI I DËRGUARI
I ALLAHUT (XH.SH).**

famëlartë janë në vetvete mrekulli të përhershme për të gjithë brezat njerëzorë dhe njëkohësisht argumenti më i besueshëm i profetizmit të Muhamedit (a.s). Ajetet kuranore që i përfshin mrekullia nuk përfundojnë së funksionuari, por do të jenë të vazhdueshme, të kultivueshme dhe të përhershme. Nuk kanë lidhje me ndodhinë lëndore, siç qe fati i

**NGRITJA E PROFETIT (A.S)
NË NDODHINË E ISRASË
DHE TË MIRAXHIT KA QENË
ME SHPIRT E ME TRUP.
KY MENDIM MBËSHKETET
NË AJETIN E QARTË:
“PA TË META ËSHTË
LARTMADHËRIA E ATIJ QË
ROBIN E VET...”**

profeti Muhamed (a.s). u tregoi atyre për Israin dhe Miraxhin. Sikur ai t'u tregonte se pau në gjumë një ëndërr dhe shpirti i tij udhëtoi në madhshtitë e Allahut (xh.sh), deri në lartësitë e universit, nuk do të ishte e çuditshme që të mohojë nga të pranishmit. P.sh ndonjëherë mund të ndodhë që t'i bisedojmë të tjerëve për ëndrrat që fluturojmë me ne deri në hapësirë ose ngjiten me ne deri në hënë dhe askush nuk do t'i marrë si të vërteta. Kësi lloj ëndrrash e të tjera që përmbajnë diçka të veçantë mund të shpjegohen për të mirë ose për të keq...

Qëndrimi i popullit ndaj informacioneve të profetit Muhamed (a.s). rreth çështjes se Israit dhe Miraxhit është argumenti më i madh se ai po u tregonte për një çështje që kishte ndodhur me veten e tij (shpirtërore e trupore). Ibn Abbas, në lidhje me fjalët e Allahut (xh.sh) në ajetin 60, të sures El-Israë: “...E këtë pamjen tënde që të treguam (natën e Miraxhit), nuk e bëmë gjë tjetër vetëm se sprovë për njerëz...”, ka thënë: “Ajo ishte një pamje e vërtetë që është realizuar nga i dërguari i Allahut, natën në të cilën është ngritur për në Bejti Mukkades”. Ndër të parët që e besoi menjëherë Profetin (a.s) për udhëtimin e realizuar ishte Ebu Bekri, i cili si rrjedhojë e besimit të tij për ngritjen e profetit Muhamed (a.s) deri në qiellin më të lartë mori

emrin Ebu Bekri Es-Sidik (i drejti).

Nga ana tjetër prej mësimëve që mund të nxjerrim nga Israi dhe Miraxhi është, siç ka treguar edhe Kur'ani famëlartë, është shtimi i besimit të mëtejshëm për besimtarët, forcimi i besimdobtëve dhe pastrimi i radhëve të myslimanëve të devotshëm nga mosbesimtarët. Ky është kuptimi i vërtetë i fjalës “fitneh (sprovë)” të theksuar në ajetin e mësipërm. Pa dyshim se ky likujdim i përcaktuar ndaj elementeve të dobët në radhët e besimdrejtëve ishte i domosdoshëm, me qëllim që të hapet porta e përgatitjes për një fazë të re të betejës së Profetit të Islamit (a.s). së bashku me sahabët e tij, e cila (kjo fazë) personifikonte hixhretin (emigrimin nga Mekka për në Medine) që ishte sakrificë më e madhe që mund të kenë paraqitur ndonjëherë besimtarët, që u lartësua me betejën e madhe dhe që përfundoi me triumfin e plotë, “...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe...” (El-Maide, 3).

Nuk është kjo e vetmja që lidhet me natën e madhe të Israsë dhe Miraxhit. U përpoqa që ta përmbledh në disa pika kryesore këtë ngjarje të vlefshme historike. Vlerën më të madhe kësaj nate të nderuar ia shton edhe obligimi i faljes së namazit të urdhëruar nga Allahu (xh.sh). Pra, u obligua falja për ummetin e Muhamedit (a.s) në pesë kohë në numër dhe në pesëdhjetë në shpërblim, sipas asaj që na ka treguar vetë Profeti ynë i nderuar me anë të haditheve të tija profetike.

Detyra jonë rreth këtij evenimenti është që të përfitojmë nga vlerat madhështore që rrjedhin prej tij, të forcojmë më tepër besimin, të kujtojmë sakrificat që ka dhënë i dërguari i fundit i Allahut, i cili në jetën e tij profetike nuk shijoi ushqimin e rehatisë, por punoi për të na shpëtuar neve nga politeizmi e besëtytnitë e kota, për të na dhënë, paqen, harmoninë me të gjithë njerëzit, lumturinë e përparimin dhe për të na bërë ashtu siç jemi sot e inshallah gjithmonë ndjekës të denjë të besimit të drejtë e të vërtetë Islam.



**“FEJA ËSHTË NJË
KUSHTETUTË QIELLORE,
E ZBRITUR NGA
KRIJUESI I BOTRAVE
PËR TË GARANTUAR
LUMTURINË E NJERIUT,
QETËSINË, SIGURINË
DHE MIRËQENIEN E TIJ.
FEJA E KA OBLIGUAR
NJERIUN TË PUNOJË
ÇDO GJË TË DOBISHME
DHE TË VLEFSHME,
SIKURSE IA KA NDALUAR
ATIJ VEPRIMIN
E ÇDO GJËJE
TË DËMSHME,
PËR INDIVIDIN
A PËR SHOQËRINË...
FEJA ËSHTË KULTURË
DHE DIJE, STUDIM
DHE KUPTIM!
FEJA ËSHTË SHËNDET
DHE PASTËRTI, VULLNET
DHE KËMBËNGULJE,
QË NUK NJEH LODHJE
AS TËRHEQJE...”**

Sheikh Ahmed Raptaro



Admir Plaku

Imam, xhamia "Ebu Bekr"

Transmetohet¹ se Hatem El-Esam ka qenë nga shokët e Shekik El-Belhit (Allahu i mëshiroftë). Një ditë e pyeti e i tha: Më ke shoqëruar më se tridhjetë vite, çfarë ke përfituar nga kjo shoqëri? Ai u përgjigj: Kam fituar shtatë gjëra të dobishme, të cilat më mjaftojnë, shpresoj me to suksesin. Atëherë Shekiku (r.a) i tha: Cilat janë? Hatem El-Esam iu përgjigj:

Dobia e parë: Vërejtja ndër njerëz dhe shikova që çdonjëri prej tyre ka të dashur, që e do dhe e dashuron. Disa nga këto të dashuruar e shoqëron deri në vdekje, disa të tjerë deri në buzë të varrit. Pastaj të gjithë kthehen dhe e lënë të vetëm. Asnjëri prej tyre nuk futet me të në varr. E mendova dhe thashë me vete që e dashura më e mirë e njeriut është ajo që qëndron me të dhe e mbështet. Nuk gjeta të dashur tjetër më të mirë, vese veprat e mira. I mora si të tilla që të jenë për mua dritë në varrin tim, të mbështetem në to dhe të mos më lënë të vetëm.

Dobia e dytë: Kam parë njerëz që udhëzohen sipas epshit, ecin e veprojnë për të arritur dëshirat e tyre. Mendova në fjalën e Allahut (xh.sh): "Kurse ai që është i frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë xhenetin". (En-Naziat:4 O-41) E besova pa mëdyshje që Kur'ani është i vërtetë dhe e kundërshtova epshin derisa e pëlqeu nënshtrimin ndaj Allahut (xh.sh).

1. "Huljetu el-Eulijae ve Tabekatu el-Esfijae", Hafidh el-Esfahani, vëllimi i 8-të, f.73-80

PËRTEJ DITURISË... DEVOTSHMËRI!

Dobia e tretë: Kam parë që do njeri prej njerëzve vrapon për të grumbulluar pasuri në këtë jetë, pastaj e mban të shtrënguara fort me duar që mos ta lërë të iki. Pastaj mendova në fjalën e Allahut (xh.sh): "Gjithëka që keni ju, është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu është e përhershme". (En-Nahl: 96) Fillova të ndiej kënaqësi me bamirësi, të ndihmoj nevojtarët ndoshta ringjallem nën hije të lëmoshës sime ditën e tubimit të njerëzimit para Zotit të gjithësisë.

Dobia e katërt: Kam parë njerëz, që nënçmojnë ca të tjerë, dhe disa kanë smirë ndaj disa të tjerëve. Konstatova që kjo smirë bëhet në pasuri, pozitë dhe dituri. Pastaj mendova në fjalën e Allahut (xh.sh): "Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd? Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, me qëllim që disa t'u shërbejnë të tjerëve. Mëshira e Zotit tënd është me e mirë nga ajo që grumbullojnë ata". (Ez-Zuhruf: 32) U binda që ndarja e rizkut është prej Allahut, që pa u krijuar dhe të qenurit i ngushtuar për këtë është fodullek. Nuk kam pasur smirë askënd dhe kam qenë i kënaqur me atë farë Allahu (xh.sh) më ka dhënë.

Dobia e pestë: Kam parë njerëz që urrejnë e armiqësojnë njëri-tjetrin për qëllime e arsye të ndryshme. Pastaj mendova në fjalën e Allahut (xh.sh): "Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik". (Fatir: 6). U binda që me të vërtetë armiqësia nuk lejohet, vetëm ndaj shejtanit. U përgatita dhe u përqendrova për ta luftuar atë.

Dobia e gjashtë: Me të vërtetë kam parë që do njeri punon me përkushtim në sigurimin e jetesës, ku mund të bie në gjëra të dyshimta apo të ndaluara(haram) madje mund të dëmtojë edhe veten e tij. E mendova fjalën e Allahut (xh.sh): "S'ka asnjë gjallesë në Tokë që të

mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij". (Hud: 6) U binda që rizku im është prej Allahut (xh.sh), iu përkushtova adhurimit të Tij dhe u largova nga gjërat e dyshimta e të ndaluara.

Dobia e shtatë: Kam parë që çdonjëri mbështetet në krijesa:

Disa i mbështeten jetës së kësaj bote dhe lekut. Disa të tjerë i mbështeten pasurisë e pushtetit, kurse disa të tjerë i mbështeten profesionit... dhe asaj që ata posedojnë. Pastaj mendova në fjalën

*"KURSE AI QË ËSHTË
I FRIKËSUAR MADHËRISË
SË ZOTIT TË TIJ
DHE E KA FRENUAR
VETEN NGA DËSHIRAT,
PA DYSHIM QË
DO TË KETË PËR STREHË
XHENETIN".
E BESOVA PA MËDYSHJE
QË KUR'ANI
ËSHTË I VËRTETË
DHE E KUNDËRSHTOVA
EPSHIN DERISA
E PËLQEU NËNSHTRIMIN
NDAJ ALLAHUT (XH.SH).*

e Allahut xh.sh: "Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai...". (Et-Talak: 3)

Iu mbështeta Allahut (xh.sh) Ai më mjafton dhe është më miri mbështetës.

Shekiku (r.a) pasi e dëgjoi me vëmendje i tha: Allahu të dhashtë mbarësi. Kam lexuar në librat e zbritur dhe kam gjetur se të gjithë përqendrohen në këto dobi. Ai që vepron me to ka punuar sipas këtyre librave hyjnorë.

KËRKOI MANGËSI DHE KUNDËRTHËNIE NË KUR'AN, GJETI DIÇKA TJETËR


Orientalisti Gery Miller, i cili u mundua të gjej kontradikta në Kura'n, pas një hulumtimi të gjatë të këtij libri pranoi Islamin dhe tani ligjëron në tematika që kanë të bëjnë me Kur'anin; shkruan portali korisno.net

Dr. Gery Miller është profesor i matematikës dhe logjikës në universitetin e Torontës. Ka qenë njëri nga "thirrësit" aktiv të krishtërimit, gjithashtu është prej atyre që ka njohuri të thella në Dhiatën e Vjetër

Filloi ta lexojë Kur'anin me qëllim që të gjej kundërthënie në të, mirëpo ai mbeti i habitur me atë çka gjeti aty.

Ai, në Kur'anin Fisnik gjeti gjëra që nuk janë në asnjë libër tjetër. Ai shpresonte të gjejë diçka që ka të bëjë me të Dërguarin e Allahut si: ndërrimi jetë i Hatixhes, gruas së tij apo për vajzat dhe djemtë e tij, mirëpo asgjë nga kjo nuk u gjet.

Gjëja që e habiti dhe e emocionoi ishte ajo se në Kur'an gjeti një sure



që mbante emrin "Merjem", ku flitej me respekt për të. Nuk ekziston diçka e ngjashme në librat e krishterë! Në anën tjetër ai nuk gjeti ndonjë sure që mbante emrin e Aishes ose Fatimes (r.a).

Gjithashtu ai zbuloi se në Kur'an, Isa (a.s) përmendet në 25 vende, ndërsa Muhamedi (a.s) vetëm në katër vende, çka edhe më shumë zgjoi emocionet e tij.

Vazhdoi të lexonte Kur'anin duke menduar se do të gjejë ndonjë kundërthënie dhe mangësi, megjithatë arriti tek ajeti i 82 i sures "Nisaa" ku thuhet:

"A nuk persiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie."

Dr Miller thotë: Nga praktika shkencore në kohën e sotme është i njohur rregulli i gjetjes së gabimeve apo zvogëlimit të tyre derisa të vërtetohet korrektësia e tij, ndërsa është e habitshme se Kur'ani Fisnik i fton muslimanët dhe jomuslimanët që të gjejnë kundërthënie në të, mirëpo nuk mund të gjejnë.

Në lidhje me këtë ajet ai thotë se: Nuk ekziston asnjë shkrimtar që posedon guxim të shkruaj ndonjë libër dhe të thotë se ai është i mbrojtur nga gabimet, mirëpo me Kur'anin është diçka tjetër. Ai të thotë: "Në të nuk ekzistojnë kundërthënie", madje ai të nxit të mundohesh të glesh kundërthënie,

mirëpo nuk mundet të glesh.

Një ajet tjetër, ku Dr. Miller ishte ndalur shumë dhe kishte menduar, ishte ajeti i 30 i sures "Enbija" ku thuhet:

"A nuk e dinë mohuesit se qiejt dhe Toka kanë qenë një e tërë? Pastaj Ne e ndamë dhe bëmë nga uji çdo gjë të gjallë! Akoma nuk besojnë?!"

Ai thotë: Po, ky ajet ka qenë temë e hulumtimit tim shkencor për të cilin unë e fitova çmimin "Nobel" në vitin 1973.

Të kthehemi te pjesa e fundit e ajetit ku thuhet se uji është burim i jetës. Dr. Miller thotë: "Në të vërtetë ky segment paraqet mbinatyrshtëri, sepse shkenca moderne vetëm kohët e fundit ka zbuluar se qenia e gjallë përbëhet nga citoplazma e cila përfaqëson 80 % të përbërjes së saj (çdo qenie të gjallë), ndërsa gjëja themelore nga e cila përbëhet citoplazma është "uji", dhe si ka mundësi që një njeri analfabet që ka jetuar para 1400 vjetëve të ketë njohuri për gjithë këtë, përveç se nëse ishte shpallje që i vinte nga Zoti.

Dr. Miller ka pranuar Islamin dhe tani mban ligjëratë në të gjithë botën. Gjithashtu ai ka zbuluar se Kur'ani është shkruar me një stil krejt të veçantë të cilit nuk i përngjan asgjë e kësaj bote.

(marrë nga: www.islammillpress.info)

*DR. MILLER KA
PRANUAR ISLAMIN
DHE TANI
MBANË LIGJËRATA
NË TË GJITHË BOTËN.
GJITHASHTU AI KA
ZBULUAR SE KUR'ANI
ËSHTË SHKRUAR
ME NJË STIL
KREJT TË VEÇANTË
TË CILIT
NUK I PËRNGJANË
ASGJË E KËSAJ BOTE.*

“MIRËNJOHJA E QYTETIT”, STUDIUESES SË MJEKËSISË BËRTHAMORE, DR. EGESTA LOPÇI

Paraditen e sotme, më 4 prill 2015, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë e dhënies së titullit: “Mirënjohja e Qytetit”, studiueses shkodrane të Mjekësisë Bërthamore, Dr. Egesta Lopçi, akorduar nga Këshilli i Bashkisë Shkodër.

Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë besimi dhe dije, ku ishin të pranishëm edhe Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Lorenc Luka, Kryetari i Këshillit të Qarkut, z. Maxhid Cungu, Kryetari i Këshillit të Bashkisë, z. Bardhyl Lohja, si dhe intelektualë të shumtë të qytetit të Shkodrës, si dhe të ardhur nga Tirana në nderim të kësaj ceremonie.

Aktiviteti u hap me një falënderim të bërë nga Dr. Leart Bërdica, që shprehu mirënjohjen e tij për Këshillin e Bashkisë Shkodër, edhe në emër të grupit organizator. Ai theksoi se ceremonia e sotme është një vlerësim për intelektualët e Shkodrës, mjekët në veçanti dhe të gjithë ata që gjejnë tek besimi në Zotin e Madhëruar, një motiv më shumë për të përparuar në jetë, në rrugën e zënies së dijes dhe praktikimit të saj në dobi të njerëzimit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, theksoi se: “E vërteta është se realitetet e sotme të qytetit tonë, kanë përherë nevojë për momente të tilla fatlume, ku mirënjohja kthehet në kryefjalë. Vlera e kësaj mirënjohjeje



peshon edhe më me shumë dinjitet e krenari, kur vendoset në duart e një njeriu, që është larguar që herët nga vendlindja e saj, ka kaluar muret e larta të lodhjes, mallit, sakrificës, paragjykitit dhe përballjes me vështirësitë e zënies së dijes, ku ka arritur maja të pashkelura më parë nga dikush tjetër.”

Më pas, me shumë emocion u zhvillua ceremonia e dorëzimit të titullit: “Mirënjohja e Qytetit” për studiuesen e talentuar shkodrane, Dr. Egesta Lopçi, e cila, në fjalën e mbajtur para të pranishëmve, theksoi se ky titull është në të vërtetë një vlerësim i madh për të dhe një respekt nga vendlindja e dashur, të cilës i ka munguar prej 15 vitesh.

Dr. Egesta Lopçi falënderoi familjen, miqtë, Myftininë Shkodër dhe Këshillin e Bashkisë për këtë

ceremoni dhe vlerësim që i bëhet personit të saj.

Më pas, mjekja e njohur, Jolanda Lopçi (nëna e Dr. Egesta Lopçi), nëpërmjet emocioneve dhe falënderimeve të shumta, tregoi për arritjet e studiueses së re shkodrane të mjekësisë bërthamore dhe vlerësimet e fituara prej saj në konferenca dhe takime ndërkombëtare, nga njëri cep i botës në tjetrin.

Znj. Lopçi theksoi se thirrja e besimit, të cilës iu dedikua e bija, që ditën e vendosjes së velit e deri më sot, ka qenë një motiv më shumë për të qenë përherë shembull i një muslimaneje të përkushtuar në jetë dhe një studiuese, që përherë ka arritur maksimumin e vlerësimeve, si në Universitetin e Bolonjës, ku është diplomuar me notë maksimale, si në konferencat shkencore ku ka prezantuar studime elitare në mënyrat e luftimit të kancereve të ndryshme nëpërmjet mjekësisë bërthamore, si në revistat e ndryshme shkencore të fushës, ku përtej dhjetra studimeve të botuara, është edhe pjesë e bordeve drejtuese. Ajo theksoi se një moment kulmor në jetën e Dr. Egesta Lopçi ishte edhe kryerja e haxhit në vitin 2010.

Pas ceremonisë, u organizuar një koktejl, ku të pranishmit uruan vajzën e re shkodrane për arritjet e saj në dije, shkencë e besim.

Dr. Egesta Lopçi jeton dhe punon në Itali.



Mbrëmjen e së hënës, më 6 prill 2015, Myftiu i Shkodrës, mori pjesë në aktivitetin kulturor që organizoi Fondacioni “Mirësia” në teatrin “Migjeni”, me mbështetjen e Myftinisë Shkodër, në promovim të vlerave të përkujdesjes ndaj jetimëve.

Me këtë rast, gjatë fjalës së tij përshëndetëse Imam Muhamed Sytari i dorëzoi Kryetarit të Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja një “Çertifikatë Mirënjohjeje”, për kontributet bamirëse të fondacionit që ai drejton, edhe në Qarkun e Shkodrës.

Në dedikimin e kësaj çertifikate, shënohet: “Në vlerësim të kontributit të madh e të shquar për rigjallërimin e vlerave islame në zonën e Shkodrës, me ndërtimin e xhamive të reja, me ndihmën e pakufijshme dhe përkrahjen e vazhdueshme ndaj jetimëve dhe njerëzve në nevojë, studentëve dhe kërkuesve të dijes, si dhe shumë projekteve bamirëse në ndihmë të pastrehëve, të përmyturve e skamnorëve, Myftinia Shkodër i akordon këtë çertifikatë mirënjohjeje: Fondacionit “Mirësia”, me lutjet më të

MYFTINIA SHKODËR, “ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJEJE” PËR FONDACIONIN “MIRËSIA”



mira për suksese të vazhdueshme dhe mbarësi në rrugën e bamirësive”.

Aktiviteti në fjalë mbledhi një numër të konsiderueshëm të jetimëve të zonës, për të cilët Fondacioni “Mirësia” jep ndihmën dhe përkrahjen e vet, në mënyrë sistematike, si dhe kontributin e vyer për arsimimin dhe përkujdesjen

e duhur ndaj kësaj shtrese sociale.

Falë bashkëpunimit të frytshëm që Myftinia Shkodër ka me Fondacionin “Mirësia” është mundësuar që në katër vitet e fundit të ndërtohen xhamitë e reja në: Kuç, Domën e Dërgut, sikurse po vijojnë punimet për disa xhami të reja në Qarkun e Shkodrës.

Paraditën e së shtunës, më 11 prill 2015, nisën punimet për themelet e xhamisë së re në fshatin Kullaj, komuna Postribë. Ceremonia u përshëndet fillimisht nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, që shfrytëzoi rastin për të theksuar bashkëpunimin e frutshëm dhe të vyer të Myftinisë Shkodër me Fondacionin “Mirësia”, pjesë e të cilit është edhe ndërtimi i xhamisë së re në Kullaj.

Myftiu tha se përtej rrënimit të xhamive dhe vlerave islame nga sistemi i çmendur ateist dhe pasuesit e tij, Drita e Zotit nuk u shua asnjëherë në zemrat dhe shpresat e muslimanëve të Shkodrës e mbarë Shqipërisë. Ai tha se Islami po lulëzon dhe ndërtimi a rindërtimi i xhamive në Shkodër dhe në çdo cep të Shqipërisë, është tregues i nevojës që kanë besimtarët për objekte kulturi të reja për kryerjen e faljeve dhe ritualeve të ndryshme në kushte të përshtatshme e bashkëkohore.

Kryetari i Komunës Postribë, z. Faz Shabaj, pasi uroi besimtarët e fshatit

HIDHEN THEMELET PËR XHAMINË E RE NË KULLAJ



Kullaj për këtë sihariq, vlerësoi punën e Myftinisë Shkodër dhe Fondacionit “Mirësia” në drejtim të pajisjes së besimtarëve me xhami dhe qendra të reja islame, ku ata edukohen me besimin dhe vlerat e kulturës islame. Ndërsa drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, uroi që punimet e nisura sot, të kenë mbarësinë e Zotit dhe të

përfundojnë me sukses. Ai shprehu falënderimet e tij për donatorët, një familje e nderuar kuvajtiane, sikurse përmendi me nderim bashkëpunimin me Myftininë Shkodër dhe komunën e Postribës.

Në shoqërinë e tekbiereve, u bë edhe hedhja simbolike e gurit të themelit për xhaminë e re të fshatit Kullaj.

HIDHEN THEMELET PËR XHAMINË E RE NË MJEDË



Paraditën e së enjtes, më 16 prill 2015, nisën punimet për hedhjen e themeleve të xhamisë së re në fshatin Mjedë, bashkia Vau Dejës. Në fjalën e tij të rastit Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, falënderoi Zotin e Madhëruar që mundësoi realizimin e kushteve për nisjen e punimeve për xhaminë e re në fshatin Mjedë. Ai përmendi me shumë respekt shembullin bamirës të plakut të mirë, rahmetliut z. Ragip Rrema (Hasmegaj), që dhuroi tokën për ndërtimin e xhamisë, për të cilin kërkoi që të lexohet një “Fatiha”, në shenjë nderimi.

Njëkohësisht, Myftiu vlerësoi bashkëpunimin e Myftinisë Shkodër me Fondacionin “Mirësia”, në drejtim të realizimit të këtij projekti të bukur e të munguar në fshatin Mjedë, sikurse uroi mbarësi dhe suksese për grupin e punës, që do të nisë

punimet në mënyrë intensive.

Në fjalën e tij, Myftiu kërkoi që besimtarët të dëshmojnë besimin e tyre dhe të mos ndikohen nga propaganda e kohës në dëm të Islamit dhe vlerave të tij universale. Nga ana e tij, drejtori i Fondacionit “Mirësia”, z. Korab Kaja, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe përmendi se fondi për realizimin e këtij projekti është dhuruar nga një zonjë e moshuar besimtare nga Kuvajti, që dëshironte ndërtimin e një xhamie në Shqipëri.

Ceremonia u përshëndet edhe nga imami i Mjeds, z. Asllan Babaj, si dhe u bë dua ja e rastit nga H. Fejzi Zaganjori, imam i xhamisë Rus.

Në shoqërinë e tekbiereve nga të pranishmit, Myftiu hodhi gurin e parë të themelit, shoqëruar edhe nga familjarët e dhuruesit të tokës, drejtori i Fondacionit “Mirësia” dhe imamët e pranishëm.



"Morali dhe vlera
e Islamit ato janë çështja;
të kemi moralin e atyre
myslimanëve të parë,
të kemi shpirtin
dhe zemrën e tyre.
Nuk qëndron çështja se,
çfarë vendosim në kokë,
sa është gjatësia e rrobave
dhe ngjyra e tyre.
Çështja është çfarë kemi
brenda kokave dhe me
çfarë merren kokat
dhe zemrat tona."

Dr. Mustafa Mahmud,
nga libri: "Islami politik"

Një ide e hedhur prej kohësh, para pak ditësh bëhet e realizueshme nga një bashkëpunim tejet frytdhënës së pari me nxënësit e ciklit të së mesmes të Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Dega e Djemve me mbështetjen e shoqatës “Istanbul” dhe njëkohësisht me dy bibliotekat e qytetit të Shkodrës, bibliotekën “Marin Barleti” dhe atë universitare “Luigj Gurakuqi”. Prej shumë kohësh sa dëgjojmë të flitet për një shtyp të heshtur në një farë mënyre, të humbur në mjegullnajën e kohës, vjen si një kontrast i këndshëm dhe i pranueshëm më së miri idea e famshme e një qyteti vatër e traditës dhe kulturës. Nisur nga një shtysë lidhur me projektet ekstrakurrikulare që vijnë si një detyrë tashmë në sistemet tona arsimore, u pa si domosdoshmëri futja në një hapësirë të tillë mjaft mbreslënëse dhe enigmatike.

Pasi u njohëm me një periodik të gjerë të botimeve të hershme në gazeta dhe revista të para viteve 90’ u përpoqëm të bënim një përzgjedhje të duhur të titujve që na u paraqitën. Gjatë kësaj kohe shfletuam me shumë kujdes revista dhe gazeta tejet interesante dhe domethënëse duke gjetur në to thesare të çmueshme të pavëna re më parë. Vumë re tituj nga më tërheqësit që menjëherë të bënin për vete, që për hir të së vërtetës përkonin plotësisht me realitetin e

“NË GJURMËT E SHTYPI TË SHKRUAR”



sotëm dhe aktualitetet, për rrjedhojë, mjaftoi ky element kyç për të na dhënë akoma më shumë energji për një punë akoma më cilësore dhe befasuese.

Të shumtë qenë titujt me të cilët u hasëm gjatë kësaj rruge si në gazeta dhe në revista si: Gazeta Mësuesi, Adriatiku, Zëri i Popullit, Flamurtari etj, si dhe SHKËNDIJA, SHEJZAT, LEKA, ALBANIA, HYLLI I DRITËS, SHKODRA, NËNTORI, REVISTA PEDAGOGJIKE etj

U përgatitën skedat e posaçme për secilën prej gazetave dhe revistave që u prezantuan duke dhënë për secilën veçori dalluese të tyre, Mjaft me interes ishin edhe shkrimet e gjetura nëpër këto botime, të cilat u pasqyruan mjeshtërisht nga një punë intensive e nxënësve për një paraqitje tejet estetike. Në mënyrë të posaçme

kujdes i kushtua prezantimit të shumë figurave të njohura, kontribuues në këto organe duke synuar një lloj rifreskimi të kujtesës së hershme duke iu kthyer të sotmes jo vetëm nostalgjik por edhe me një shpresë pozitive për të ripërtërirë sado pakëz këtë të fshehtë historike dhe jo vetëm.

Një çast kulminant i këtij aktiviteti ishte një interpretim mjaft goditës dhe kumbues i një poezie titulluar “NJITIM PERËNDIS”, e shkruar në vitin 1923 në revistën “ZANI I NALTË”, organ ky i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, shkruar nga Hafiz Shaqir Oruqi sjellur tashmë pas 85 vitesh nga medresisti Enis Rexhaj.

Në fund të programit për të pranishmit u dha një koktejl.

Një tjetër projekt i realizuar me shumë sukses nga nxënësit e klasave të 11-ta të Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” Dega e Djemve ishte ai i titulluar “Mjedisi i gjelbërt, frymëmarrje për jetën” në kuadër të projektit qytetar që tashmë medreseja prej vitesh organizon. Këtë herë nxënësit iu drejtuan hapësirës së gjelbërt në majat e Taraboshit. Të drejtuar nga mësuesit i tyre dhe përgjegjësi i projektit z Ylber Dyli në bashkëpunim me shoqatën “Istanbul” dhe Ndërmarrjen Pyjore ata arritën të mbillnin rreth 70 fidane 5-vjeçar. Kjo punë u iniciua prej disa ditësh ku nxënësit punuan me shumë dëshirë dhe pasion për vënien në zbatim të një projekti të tillë, në thelb të së cilit qëndronte rritja e numrit të

“MJEDISI I GJELBËR, FRYMËMARRJE PËR JETËN”



hapësirave të gjelbërta në vendin ku jetojmë dhe veçanërisht nxitja e brezit të ri në një sipërmarrje të tillë.

Prej vitesh nxënësit e Medresesë

punojnë pa reshtur në të tilla realizime të projektit qytetar ku idetë e paraqitura kanë qenë intriguese dhe mjaft domethënëse.

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



Filluan regjistrimet

për vitin shkollor **2015-2016**

Për klasat e **6**-ta dhe të **10**-ta
PROVIMI zhvillohet

30 maj 2015
ora: 10.00

PËR HERË TË PARË

CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

Adresa: Dega vajza, Lagjja: Perash, Rr. "M. Pashë Plaku", Nr. 62 | Dega Djem, Lagjja: "Luguçezme"

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja
Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org